

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 5, datë 2.4.2026

PËRPËRCAKTIMIN E NUMRIT, PROCEDURAVE DHE KRITEREVE TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOSSHME PËR VEPRIMTARINË STATISTIKORE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE PESHKIMIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, të ndryshuar; ligjit të nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, aneksi 5, pika 2, vendimit nr. 109, datë 6.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për vendosjen e standardeve në kryerjen e disa aktiviteteve me punonjës të përkohshëm, në njësitë e qeverisjes qendrore”, ministri i Financave dhe ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

UDHËZOJNË

1. Për realizimin e veprimtarisë statistikore, si proces që siguron prodhimin e treguesve statistikorë për bujqësinë, blegtorinë dhe peshkimin, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural rekruton punonjës me kontratë të përkohshme.

2. Punonjësit luajnë rol mbështetës në realizimin e të gjitha fazave të procesit të vrojtimeve statistikore në fushat përkatëse, duke përfshirë në mënyrë të veçantë, mbledhjen e të dhënave në terren, verifikimin dhe kontrollin e cilësisë së tyre, si dhe hedhjen dhe përpunimin e të dhënave në sistemet elektronike përkatëse.

3. Kategoritë e punonjësve dhe detyrat e tyre:

3.1. Për vrojtimit bujqësore, të cilat kryhen dy herë në vit:

a) Kontrollorë anketimi

Janë punonjës mbështetës të specialistëve të statistikës në Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor. Kriteri i rekrutimit të tyre nuk parashikon domosdoshmërisht diplomë universitare.

Detyrat kryesore:

i. Kontrollon me kujdes instrumentet e anketës dhe cilësinë e intervistave, duke verifikuar saktësinë e të dhënave të hedhura në përputhje me pyetësorët;

ii. Zbaton udhëzimet, rekomandimet dhe afatet e përcaktuara nga stafi përgjegjës për kontrollin e anketës;

iii. Organizon dhe realizon në mënyrë të përditshme kontrollin e intervistave, duke siguruar shpërndarje proporcionale të tyre sipas planifikimit mujor;

iv. Komunikon rregullisht me anketuesit për ecurinë e punës dhe problematikat e hasura, duke ofruar mbështetje kur është e nevojshme;

v. Kryen kontrollin e intervistave në përputhje me listat përkatëse të anketuesve të bashkëngjitura kontratave;

vi. Informon subjektet për qëllimin e anketës dhe garanton përdorimin e të dhënave vetëm për qëllime statistikore, duke respektuar anonimin;

vii. Mban përgjegjësi për cilësinë e të dhënave pas procesit të kontrollit;

viii. Respekton Kodin e Etikës, shmang konfliktin e interesit dhe përdor mjetin e identifikimit gjatë ushtrimit të detyrës;

ix. Ruajnë konfidencialitetin e dokumenteve dhe informacionit, edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës;

x. Njofton me shkrim për çdo pamundësi në përmbushjen e detyrave dhe mban përgjegjësi në rast shkeljesh, sipas legjislacionit në fuqi.

b) Anketues

Janë punonjës që realizojnë intervistimeve në terren. Kriteri i rekrutimit të tyre nuk parashikon domosdoshmërisht diplomë universitare.

Detyrat kryesore:

Zbaton udhëzimet, rekomandimet dhe afatet e përcaktuara për realizimin e anketës;

i. Realizon intervistat sipas planifikimit ditor, duke siguruar shpërndarje proporcionale të tyre gjatë periudhës së punës;

ii. Kryen intervistat në terren përmes kontakteve dhe vizitave direkte, duke respektuar procedurat dhe duke garantuar saktësinë e pyetjeve sipas pyetësorëve;

iii. Informon subjektet mbi qëllimin e anketës dhe garanton përdorimin e të dhënave vetëm për qëllime statistikore, duke respektuar anonimin;

iv. Mban përgjegjësi për cilësinë dhe saktësinë e të dhënave të mbledhura dhe të regjistruara;

v. Garanton ruajtjen e konfidencialitetit të dokumenteve dhe informacionit, edhe pas përfundimit të kontratës;

c) Operatorë

Janë punonjës mbështetës të specialistëve të statistikës në Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor. Kriteri i rekrutimit të tyre nuk parashikon domosdoshmërisht diplomë universitare.

Detyrat kryesore:

Hedhja dhe kontrolli i të dhënave në sistemet elektronike.

3.2. Për vrojtimit bujqësore gjatë vitit

a) Kontrollorë

Janë punonjës mbështetës të specialistëve të statistikës në Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor dhe në Drejtorinë e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës. Kriteri i rekrutimit të tyre nuk parashikon domosdoshmërisht diplomë universitare.

Detyrat kryesore:

i. Kontrollon dhe verifikon saktësinë e të dhënave të deklaruara dhe të grumbulluara, në përputhje me formularët, udhëzimet dhe kërkesat përkatëse;

ii. Zbaton udhëzimet dhe rekomandimet e stafit përgjegjës për kontrollin dhe përpunimin e të dhënave përpara hedhjes në sistem;

iii. Komunikon rregullisht me operatorët dhe strukturat përkatëse për problematikat, saktësimin e të dhënave dhe realizimin e detyrave ditore;

iv. Angazhohet në terren, sipas nevojës, për monitorimin dhe azhurnimin e të dhënave në bashkëpunim me strukturat përkatëse;

v. Bashkëpunon me specialistët e statistikës për zgjidhjen e paqartësive teknike dhe realizon raportim periodik mbi ecurinë e punës;

vi. Verifikon plotësimin korrekt të të dhënave në sistem dhe mban përgjegjësi për cilësinë e tyre pas kontrollit;

vii. Koordinon dhe mbikëqyr procesin e punës së monitoruesve dhe anketuesve, duke dhënë udhëzime konkrete për realizimin e detyrave;

viii. Harton dhe përpunon raportet dhe tabelat përmbledhëse të të dhënave, përfshirë zëniet e peshkut dhe ndarjet periodike sipas kërkesave institucionale;

ix. Raporton mbi ecurinë e punës pranë strukturave drejtuese përkatëse.

b) Anketues

Janë punonjës mbështetës të specialistëve të statistikës në Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor dhe në Drejtorinë e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës, që realizojnë intervistime në terren. Kriteri i rekrutimit të tyre nuk parashikon domosdoshmërisht diplomë universitare.

Detyrat kryesore:

i. Grumbullon të dhëna mbi zëniet e peshkut dhe aktivitetin e peshkimit, në përputhje me kërkesat kombëtare dhe ndërkombëtare;

ii. Mbledh informacion drejtpërdrejt nga burimet përkatëse, përfshirë anijet e peshkimit, subjektet e peshkimit dhe akuakulturës, si dhe organizatat e menaxhimit të peshkimit;

iii. Interviston pronarë, kapitenë dhe peshkatarë për sigurimin e të dhënave të sakta dhe të plota;

iv. Grumbullon të dhëna socio-ekonomike për vlerësimin e performancës së sektorit të peshkimit dhe akuakulturës;

v. Përpunon dhe dorëzon të dhënat e mbledhura pranë strukturave përgjegjëse;

vi. Kryen analiza bazë mbi të dhënat, sipas nevojave të sektorit.

c) Operatorë

Janë punonjës mbështetës të specialistëve të statistikës në Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor dhe në Drejtorinë e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës. Kriteri i rekrutimit të tyre nuk parashikon domosdoshmërisht diplomë universitare.

Detyrat kryesore:

i. Realizon mbledhjen, vëzhgimin dhe monitorimin e të dhënave statistikore;

ii. Monitoron çmimet ditore në tregjet me shumicë të frutave dhe perimeve, sipas varieteteve, cilësisë dhe rajoneve;

iii. Komunikon rregullisht me kontrollorin e qarkut për ecurinë e punës, problematikat dhe sqarimet e nevojshme, përpara hedhjes së të dhënave në sistem;

iv. Angazhohet në terren për azhurnimin e të dhënave në bashkëpunim me strukturat përkatëse;

v. Verifikon, saktëson dhe përditëson të dhënat përpara hedhjes në sistem, në koordinim me specialistët përkatës.

4. Periudha e punësimit:

a) Punonjësit e parashikuar në pikën 3.1 angazhohen me kohë të plotë (8 orë në ditë), për një periudhë jo më të gjatë se 1 (një) muaj për çdo proces vrojtimi (jo më shumë se dy vrojtime në vit).

b) Punonjësit e parashikuar në pikën 3.2 angazhohen me kohë të pjesshme, deri në 6 (gjashtë) orë në muaj, në bazë vjetore.

5. Përgjegjësitë funksionale: Ngarkohen me përgjegjësi për grumbullimin, përpunimin dhe dorëzimin e të dhënave punonjësit që ushtrojnë funksione statistikore pranë njësive përgjegjëse në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR).

6. Grumbullimi i të dhënave: Të dhënat e grumbulluara përcillen nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural pranë Institutit të Statistikave (INSTAT), në përputhje me procedurat dhe standardet në fuqi.

7. Niveli i pagës për çdo kategori punonjësish, përcaktohet në bazë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, që miraton elementet e pagës mujore për punonjësit mbështetës.

8. Fondet për përballimin e shpenzimeve të personelit të përkohshëm mbulohen nga fondet e shpenzimeve korrente, të miratuara në buxhetin vjetor të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

9. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural miraton numrin e punonjësve me kontratë për secilën kategori me shkresë të Sekretarit të Përgjithshëm, përcakton afatet e punësimit duke vënë në dijeni Degët Rajonale të Thesarit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit.

10. Për shkak të natyrës së veçantë të punës, si masë garantuese për cilësinë dhe saktësinë e të dhënave të grumbulluara, pagesa e punonjësve mbështetës kryhet vetëm pas verifikimit të cilësisë së pyetësorëve dhe përfundimit të procesit të hedhjes së të dhënave në bazën elektronike.

11. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (Tiranë, Shkodër, Korçë, Lushnjë) dhe Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Andis Salla

MINISTËR I FINANCAVE

Petrit Malaj